LIGJ
Nr. 16/2012

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8752, DATË 26.3.2001 "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE PËR ADMINISTRIMIN DHE MBROJTJEN E TOKËS", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni l

Në nenin 11/1 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

"4. Miratimi i ndryshimit të kategorisë së resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh dhe kalimi i tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet nga komisioni që krijohet pranë komunës ose bashkisë, i cili kryesohet nga kryetari i komunës ose bashkisë dhe që ka në përbërje këta anëtarë:

a) një përfaqësues të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë (DRB);

b) një përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit Pyjor (DSHP);

c) një përfaqësues të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës(DAMT) të qarkut;

ç) përgjegjësin e Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (ZMMT);

d) juristin e komunës dhe/ose bashkisë.

2. Pas pikës 4 shtohen pikat 4/1, 4/2, 4/3, 4/4 dhe 4/5 me këtë përmbajtje:

"4/1. Kërkesa për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategorinë e resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, kur kategoritë që kërkohet të ndryshohen janë në pronësi private, bëhet vetëm nga pronarët e tyre, ndërsa kur janë në pronësi të komunës ose bashkisë, kërkesa në komision paraqitet nga ZMMT-ja e njësisë së qeverisjes vendore.

Fondi i tokës bujqësore i krijuar nga ndryshimi i kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh që janë në pronësi të komunave dhe bashkive, administrohet sipas legjislacionit në fuqi për tokat bujqësore të pandara.

4/2. Ndryshimi i kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategori të resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, ndërmerret vetëm kur paraqiten projekte zhvillimi afatgjata të kulturave bujqësore, që përputhen me programet mbështetëse të qeverisë.

4/3. Kryetari i komunës ose bashkisë detyrohet të mbledhë komisionin dhe të shqyrtojë kërkesat për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategorinë e resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e regjistrimit të tyre.

4/4. Subjekti që ka paraqitur kërkesë për ndryshim të kategorive të resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh, në kategorinë e resursit tokë bujqësore, sipas pikës 4 të këtij neni, kur komisioni rrëzon kërkesën e paraqitur ose nuk e shqyrton atë brenda afatit të përcaktuar, ka të drejtë ta paraqesë këtë kërkesë për vendimmarrje në ministritë, veprimtaria e të cilave mbulon këto kategori resursesh.".

4/5. Ndryshimi i kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategoritë e resurseve pyll, kullotë dhe livadh bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore, i cili i ka në përdorim këto toka. Kërkesa për ndryshimin paraqitet pranë ministrisë, veprimtaria e së cilës mbulon këtë kategori resursi. Miratimi i ndryshimit bëhet:

a) për sipërfaqet deri në 5 ha, me urdhër të ministrit përkatës;

b) për sipërfaqet mbi 5 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Ndryshimi i tokës së pafrytshme në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo të organit të qeverisjes vendore, i cili e ka në pronësi ose në përdorim këtë resurs, dhe miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.”.

4. Pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Ndryshimi i tokës bujqësore në kategorinë e resursit tokë e pafrytshme, kur mbi këto sipërfaqe dokumentohet se kanë ndikuar faktorë natyrorë të fuqisë madhore, bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore i cili e ka në përdorim këtë resurs. Kërkesa për ndryshim paraqitet pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit. Miratimi i ndryshimit bëhet:

a) për sipërfaqet deri në 5 ha, me urdhër të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

b) për sipërfaqet mbi 5 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

5. Në pikën 6, fjalët “sipas pikave 1 deri në 5 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “sipas pikave 1 deri në 5/1 të këtij neni”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7307, datë 6.3.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi